



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:123240

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06005638

KPPP.nr.1577/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Telekom i Kosovës SH.A., me NUI: 811288001, me seli në Prishtinë, kundër debitorit Trepça SH.A, me NUI: 811278747 me seli në rr. “Parku Industrial” në Mitrovicë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.132/21 të datës 31.03.2021, të Përmbartuesit Privat Emine Sherifi-Lubeniqi me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Trepça SH.A., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.132/21 të datës 31.03.2021 të Përmbartuesit Privat Emine Sherifi-Lubeniqi.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.132/21 i datës 31.03.2021 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Telekom i Kosovës SH.A., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.132/21 të datës 31.03.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumenteve të besueshme si në vijim: Faturës Nr. 2065/550071917 të datës 31.12.2020; Faturës Nr. 2060/550071917 të datës 30.11.2020; Faturës Nr. 2054/550071917 të datës 31.10.2020; Faturës Nr. 2041/550071917 të datës 30.09.2020; Faturës Nr. 2032/550071917 të datës 31.08.2020; Faturës Nr. 2028/550071917 të datës 31.07.2020; Faturës Nr. 2022/550071917 të datës 30.06.2020; Faturës Nr. 2017/550071917 të datës

31.05.2020; Faturës Nr. Ser 2010/550071917 të datës 30.04.2020; Faturës Nr. Ser 2005/550071917 të datës 31.03.2020; Faturës Nr. 1997/550071917 të datës 29.02.2020; Faturës Nr. 1988/550071917 të datës 31.01.2020; Faturës Nr. 1980/550071917 të datës 31.12.2019; Faturës Nr. 1977/550071917 të datës 30.11.2019; Faturës Nr. 1965/550071917 të datës 31.10.2019; Faturës Nr. 1956/550071917 të datës 30.09.2019; Faturës Nr. 1952/550071917 të datës 31.08.2019; Faturës Nr.1946/550071917 të datës 31.07.2019, Faturës Nr. 2065/550071938 të datës 31.12.2020; Faturës Nr. 2060/550071938 të datës 30.11.2020; Faturës Nr. 2054/550071938 të datës 31.10.2020; Faturës Nr. 2041/550071938 të datës 30.09.2020; Faturës Nr. 2032/550071938 të datës 31.08.2020; Faturës Nr. 2028/550071938 të datës 31.07.2020; Faturës Nr. 2022/550071938 të datës 30.06.2020; Faturës Nr. 2017/550071938 të datës 31.05.2020; Faturës Nr. 2010/550071938 të datës 30.04.2020; Faturës Nr. 2005/550071938 të datës 31.03.2020; Faturës Nr. 1997/550071938 të datës 29.02.2020; Faturës Nr. 1988/550071938 të datës 31.01.2020; Faturës Nr. 1980/550071938 të datës 31.12.2019; Faturës Nr. 1977/550071938 të datës 30.11.2019; Faturës Nr. 1965/550071938 të datës 31.10.2019; Faturës Nr. 1956/550071938 të datës 30.09.2019; Faturës Nr. 1952/550071938 të datës 31.08.2019; Faturës Nr. 1946/550071938 të datës 31.07.2019, Faturës Nr. 2065/550005612 të datës 31.12.2020; Faturës Nr. 2060/550005612 të datës 30.11.2020; Faturës Nr. 2054/550005612 të datës 31.10.2020; Faturës Nr. 2041/550005612 të datës 30.09.2020; Faturës Nr. 2032/550005612 të datës 31.08.2020; Faturës Nr. 2028/550005612 të datës 31.07.2020; Faturës Nr. 2022/550005612 të datës 30.06.2020; Faturës Nr. 2017/550005612 të datës 31.05.2020; Faturës Nr. 2010/550005612 të datës 30.04.2020; Faturës Nr. 2005/550005612 të datës 31.03.2020; Faturës Nr. 1997/550005612 të datës 29.02.2020; Faturës Nr. 1988/550005612 të datës 31.01.2020; Faturës Nr. 1980/550005612 të datës 31.12.2019; Faturës Nr. 1977/550005612 të datës 30.11.2019; Faturës Nr. 1965/550005612 të datës 31.10.2019; Faturës Nr. 1956/550005612 të datës 30.09.2019, Faturës Nr. 2065/550015641 të datës 31.12.2020; Faturës Nr. 2060/550015641 të datës 30.11.2020; Faturës Nr. 2054/550015641 të datës 31.10.2020; 2041/550015641 të datës 30.09.2020; Faturës Nr. 2032/550015641 të datës 31.08.2020; Faturës Nr. 2028/550015641 të datës 31.07.2020; Faturës Nr. 2022/550015641 të datës 30.06.2020; Faturës Nr. 2017/550015641 të datës 31.05.2020; Faturës Nr. 2010/550015641 të datës 30.04.2020; Faturës Nr 2005/550015641 të datës 31.03.2020; Faturës Nr. 1997/550015641 të datës 29.02.2020; Faturës Nr. 1988/550015641 të datës 31.01.2020; Faturës Nr. 1980/550015641 të datës 31.12.2019; Faturës Nr. 1977/550015641 të datës 30.11.2019; Faturës Nr. 1965/550015641 të datës 31.10.2019; Faturës Nr. 1956/550015641 të datës 30.09.2019, Faturës Nr. 2065/550070945 të datës 31.12.2020; Faturës Nr. Ser

2060/550070945 të datës 30.11.2020; Faturës Nr. 2054/550070945 të datës 31.10.2020; Faturës Nr. 2041/550070945 të datës 30.09.2020; Faturës Nr.2032/550070945 të datës 03.08.2020; Faturës Nr. 2028/550070945 të datës 31.07.2020; Faturës Nr. 2022/550070945 të datës 30.06.2020; Faturës Nr. 2017/550070945 të datës 31.05.2020; Faturës Nr. 2010/550070945 të datës 30.04.2020; Faturës Nr. 2005/550070945 të datës 31.03.2020; Faturës Nr. 1997/550070945 të datës 29.02.2020; Faturës Nr. 1988/550070945 të datës 31.01.2020; Faturës Nr. 1980/550070945 të datës 31.12.2019; Faturës Nr. 1977/550070945 të datës 30.11.2019; Faturës Nr. 1965/550070945 të datës 31.10.2019; Faturës Nr. 1956/550070945 të datës 30.09.2019; Faturës Nr. 1952/550070945 të datës 31.08.2019; Faturës Nr. 1946/550070945 të datës 31.07.2019, Faturës Nr. 2065/550000429 të datës 31.12.2020; Faturës Nr 2060/550000429 të datës 30.11.2020; Faturës Nr. 2054/550000429 të 31.10.2020; Faturës Nr. 2041/550000429 të datës 30.09.2020; Faturës Nr. 2032/550000429 të datës 31.08.2020; Faturës Nr. 2028/550000429 të datës 31.07.2020; Faturës Nr. 2022/550000429 të datës 30.06.2020; Faturës Nr. 2017/550000429 të datës 31.05.2020; Faturës Nr. 2010/550000429 të datës 30.04.2020; Faturës Nr.2005/550000429 të datës 31.03.2020; Faturës Nr. 1997/550000429 të datës 29.02.2020; Faturës Nr. 1988/550000429 të datës 31.01.2020; Faturës Nr. 1980/550000429 të datës 31.12.2019; Faturës Nr. 1977/550000429 të datës 30.11.2019; Faturës Nr. 1965/550000429 të datës 31.10.2019; Faturës Nr. 1956/550000429 të datës 30.09.2019; Faturës Nr. 1952/550000429 të datës 31.08.2019; Faturës Nr. 1946/550000429 të datës 31.07.2019, Faturës Nr. 2065/550024494 të datës 31.12.2020; Faturës Nr. 2060/550024494 të datës 30.11.2020; Faturës Nr. 2054/550024494 të datës 31.10.2020; Faturës Nr. 2041/550024494 të datës 30.09.2020; Faturës Nr. 2032/550024494 të datës 31.08.2020; Faturës Nr. 2028/550024494 të datës 31.07.2020; Faturës Nr. 2022/550024494 të datës 30.06.2020; Faturës Nr. 2017/550024494 të datës 31.05.2020; Faturës Nr. 2010/550024494 të datës 30.04.2020; Faturës Nr. 2005/550024494 të datës 31.03.2020; Faturës Nr. 1997/550024494 të datës 29.02.2020; Faturës Nr. 1988/550024494 të datës 31.01.2020; Faturës Nr. 1980/550024494 të datës 31.12.2019; Faturës Nr. 1977/550024494 të datës 30.11.2019; Faturës Nr. 1965/550024494 të datës 31.10.2019; Faturës Nr. 1956/550024494 të datës 30.09.2019, Faturës Nr. 2065/550025938 të datës 31.12.2020; Faturës Nr. 2060/550025938 të datës 30.11.2020; Faturës Nr. 2054/550025938 të datës 31.10.2020; Faturës Nr. 2041/550025938 të datës 30.09.2020; Faturës Nr. 2032/550025938 të datës 31.08.2020; Faturës Nr. 2028/550025938 të datës 31.07.2020; Faturës Nr. 2022/550025938 të datës 30.06.2020; Faturës Nr. 2017/550025938 të datës 31.05.2020; Faturës Nr. 2010/550025938 të datës 30.04.2020; Faturës Nr. 2005/550025938 të datës 31.03.2020; Faturës Nr. 1997/550025938 të datës 29.02.2020;

Faturës Nr. 1988/550025938 të datës 31.01.2020; Faturës Nr. 1980/550025938 të datës 31.12.2019; Faturës Nr. 1977/550025938 të datës 30.11.2019; Faturës Nr. 1965/550025938 të datës 31.10.2019; Faturës Nr. 1956/550025938 të datës 30.09.2019, Faturës Nr. 2065/150820055439 të datës 31.12.2020; Faturës Nr. 2060/150820055439 të datës 30.11.2020; Faturës Nr. 2054/150820055439 të datës 31.10.2020; Faturës Nr. 2041/150820055439 të datës 30.09.2020; Faturës Nr. 2032/150820055439 të datës 31.08.2020; Faturës Nr.2028/150820055439 të datës 31.07.2020; Faturës Nr. 2022/150820055439 të datës 30.06.2020; Faturës Nr. 2017/150820055439 të datës 31.05.2020; Faturës Nr. 2010/150820055439 të datës 30.04.2020; Faturës Nr. 2005/150820055439 të datës 31.03.2020; Faturës Nr. 1997/150820055439 të datës 29.02.2020; Faturës Nr. 1988/150820055439 të datës 31.01.2020; Faturës Nr. 1980/150820055439 të datës 31.12.2019; Faturës Nr. 1977/150820055439 të datës 30.11.2019; Faturës Nr. 1965/150820055439 të datës 31.10.2019 dhe Faturës Nr. 1956/150820055439 të datës 30.09.2019, me të cilin e ka detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga faturat e lartcekura, brenda afatit 7 ditor nga dita e dorëzimit të urdhrin, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 11,953.90 €, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data kur kredia është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbimore, ashtu që të gjitha këto detyrime të realizohen përmes zbatimit të përmbimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë bankare të zyrës përmbimore të përmbaruesit privat, ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, zyra përmbimore të zbatoj përmbimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, e ka kundërshtuar urdhrin përmbimor me arsyetimin se dokumenti në bazë të së cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, duke theksuar se shuma e përgjithshme e borxhit të kërkuar në vlerën prej 11,953.90 € nuk është e saktë, sepse faturat të cilat janë të bashkëngjitura në propozimin për përmbim nuk përputhen me faturat të cilat gjenden në Departamentin e Financave të debitorit, ku vlera aktuale e borxhit është në shumën prej 11,314.00 €. I ka propozuar gjykatës që të anuloj urdhrin për përmbim.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke theksuar se faturat mbi bazën e të cilave është inicuar

propozimi për përmbardim, janë dokumente të besueshme, gjë e cila dëshmohet në shkresat e lëndës dhe nga këto fatura konstatohet dhe provohet se kreditori ka vepruar konform dispozitave ligjore. Në lidhje me pretendimet e debitorit se faturat e bashkëngjitura nuk përputhen me faturat të cilat gjenden në Departamentin e Financave të debitorit, ka theksuar se nuk qëndrojnë, meqenëse nga informatat që kreditori i ka marr pas paraqitjes së prapësimit nga ana e debitorit, ka rezultuar se gjendja e borxhit është në shumën prej 11,953.00 €. Në fund ka theksuar që debitori nuk e ka mohuar borxhin dhe as shërbimet të cilat i ka ofruar kreditori. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe vazhdojë me përmbardimin e urdhrit të lartcekur.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbardim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbardim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbardimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar ”*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbarduesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - faturat të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit

29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, koha e përmbushjes së këtij detyrimi si dhe të njëjtat janë bërë të arritshme për pagesë.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, si dhe nuk janë kontestuar nga debitori.

Gjykata po ashtu shqyrtoi pretendimin e debitorit sa i përket lartësisë së detyrimit përkatësisht se në rastin konkret detyrimi i debitorit është në shumën prej 11,314.00 €, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pa bazuar, për faktin se debitori nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi përmes së cilës do të mund të vërtetohej një fakt i tillë, edhe pse i njëjti e ka pasur detyrim që prapësimin të ia bashkëngjis provat me shkrim siç përcaktohet në dispozitën e nenit 69 par.4 të LPP-së.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1577/23, datë 31.07.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.